



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:178445  
Datë: 23.10.2024  
Numri i dokumentit: 06339221

C.nr.2704/23

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Shyqri Hoxha, me praktikanten gjyqësore D.O. në çështjen kontestimore të paditësve B.M. me numër personal ..... B.V. me numër personal .... dhe B.B. numër personal ..... nga Prizreni të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë av. D.Sh. dhe av. N.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2.500.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 23.10.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht** e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.M., B.V., dhe B.B. që të gjithë nga Prizreni.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit të i'u kompensoj dhe atë:

- Paditëses B.M.
  1. Për periudhën kohore korrik - Dhjetor 2020, në shumën prej 5,02 euro;
  2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.72 euro;
  3. Për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro,

E në shumën e përgjithshme prej 699.22 euro për secilën paditëse, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Paditëses B.V.
  1. Për periudhën kohore Gusht - Dhjetor 2020, në shumën prej 5,02 euro;
  2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.72 euro;
  3. Për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro.

E në shumën e përgjithshme prej 699.22 euro për secilën paditëse, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

- Paditëses B.B.

1. Për periudhën kohore Gusht - Dhjetor 2020, në shumën prej 5,02 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.72 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro.

E në shumën e përgjithshme prej 699.22 euro për secilën paditëse, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve të ia paguaj shumën prej 239.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**IV. REFUZOHET** e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit përkatësisht shuma prej 5,60 euro, për secilin paditësnë emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

### **A r s y e t i m**

Paditëset B.M., B.V., dhe B.B. nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë av. D.Sh. dhe av. N.M. nga Prizreni, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni - Drejtoria Komunale e Arsimit, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në shkollën "Emin Duraku" në Prizren dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2020, 2021 dhe 2022, për paditësen B.M. është është në lartësi prej 1,056.87 euro, për paditësen është është B.V. në lartësi prej 1,015.00 euro, si dhe për paditësen B.B. është është në lartësi prej 436.06 euro. Po ashtu, ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Përmes parashtrës së dt. 08.12.2023, paditëset përmes të autorizuarve të tyre kanë kërkuar kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2020, 2021 dhe 2022, për secilën nga 704.28 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 2,112.84 euro, llogaritur në pagën bazë që të njëjtat e realizojnë në shumë prej 421.00 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 04.01.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësve nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me Nr.prot. 672/2015 e datës 14.10.2025 për paditësen B.M. e lëshuar nga Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën "Emin Duraku", si mësimdhënëse klasore. Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me Nr.prot.123/2017 e datës 21.04.2017 për paditësen B.V. e lëshuar nga Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën "Emin Duraku", si mësimdhënëse e edukatës muzikore. Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se

nga Kontrata e punës me Nr.prot.585/2016 e datës 06.10.2016 për paditësen B.B. e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën “Emin Duraku”, si mësimdhënëse lëndore.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve B.M., B.V., dhe B.B. është për secilën veç e veç shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve B.M., B.V., dhe B.B. i takon secilës veç e veç e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësen B.M.

- Për periudhën 01.07.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5,04 euro ( $421 * 0.2\% = 0,84 * 6 \text{ muaj} = 5,04$ ).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2021 ka qenë 421.euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është 171,72 euro ( $421.2*3.4\%=14,32*12 \text{ muaj} =171,72 \text{ euro}$ ).

- Për periudhën 01.01.2022 - 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që uke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00, i bie që përqindja e inflacionit është dashur të futej në pagën bazë është  $(421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30)$  si dhe periudha 21 ditë të muajit nëntor të vitit 2022 është shuma prej 34.18 euro, sipas llogaritjes  $(48.83 / 30 = 1.6 * 21 \text{ ditë} = 34.18) = 488,30 + 34,18 = 522,48$  euro.

#### Për paditësen B.V.

- Për periudhën 01.07.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5,04 euro  $(421 * 0.2\% = 0,84 * 6 \text{ muaj} = 5,04)$ .
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2021 ka qenë 421.euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është 171,72 euro  $(421.2 * 3.4\% = 14,32 * 12 \text{ muaj} = 171,72 \text{ euro})$ .
- Për periudhën 01.01.2022 - 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që uke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00, i bie që përqindja e inflacionit q është dashur të futej në pagën bazë është  $(421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30)$  si dhe periudha 21 ditë të muajit nëntor të vitit 2022 është shuma prej 34.18 euro, sipas llogaritjes  $(48.83 / 30 = 1.6 * 21 \text{ ditë} = 34.18) = 488,30 + 34,18 = 522,48$  euro.

#### Për paditësen B.B.

- Për periudhën 01.07.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5,04 euro  $(421 * 0.2\% = 0,84 * 6 \text{ muaj} = 5,04)$ .
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e secilit paditës në vitin 2021 ka qenë 421.euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për secilin paditës është 171,72 euro  $(421.2 * 3.4\% = 14,32 * 12 \text{ muaj} = 171,72 \text{ euro})$ .
- Për periudhën 01.01.2022 - 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që uke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00, i bie që përqindja e inflacionit q është dashur të futej në pagën bazë është  $(421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30)$  si dhe periudha 21 ditë

të muajit nëntor të vitit 2022 është shuma prej 34.18 euro, sipas llogaritjes  $(48.83/30=1.6*21 \text{ ditë}=34.18)=488,30+34,18=522,48$  euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 22.08.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 30.07.2020.

Me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 22.08.2023, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.07.2020 e deri më 21.11.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 22.08.2023, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin korrik 2020, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësve për muajin korrik 2020 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimit të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin korrik 2020 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht shtator 2020, e njëjta ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 31.07.2020 si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësi në shumë prej 421.00 dhe asaj që paditësit e realizojnë e që është në shumë prej 421.00 euro, pra shuma e tërësishme e parashkruar dhe pabazuar për të tre paditësit është në lartësi prej 17.49 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.08.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës

Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 208 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 31 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 239.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.2704/23, datë 23.10.2024**

**G j y q t a r i**

**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.